



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 72/1 Prot.

Tiranë, më 15/12 /2011

Lënda: Rekomandim për Laboratorin Mjekësor “Neo-Style”.

REKOMANDIM

Nr. 72/1, datë 15, 12 2011

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Laborator Mjekësor “Neo-Style”;

KONSTATOVA

Më datë 26/11/2011, nga grupi i kontrollit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, Laborator Mjekësor “Neo-Style” me objekt:

- 1- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave sensitive, transferimi ndërkombëtar i të dhënave të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- 2- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë autoritetit të Komisionerit, në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21);
- 3- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27);
- 4- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese.

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

- 1- Kontrolluesi, Laborator Mjekësor “Neo-Style” Tiranë, nuk është shprehur në një rregullore të brendshme të hartuara prej tij lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në zbatim të neneve 27/2 “c”, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Moskryerja e kësaj detyre ligjore përbën shkelje të kërkesave të nenit 27/2/c të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”; “Kontrolluesi, udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave”. Gjithashtu, mungojnë politikat e mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet konfidencialitetit, të parashikuara në Nenin 28 të Ligjit.

Për sa më sipër, në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të Kodit të Proçedurave Administrative:

REKOMANDOJ

1. Bazuar në nenet 27/2 ”c” dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartoni Rregullore të Brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, brenda një afati prej 20 (njëzet) ditësh. Për hartimin e kësaj Rregulloreje mund të asistoheni dhe të merrni mendimin e Zyrës së Komisionerit;
2. Me kalimin e afatit, në rast mospërbushjeje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas Nenit 39 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

